





SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION

REFERENCË:	SPK-01/010/2023	DATE: 18.07.2023
PËR/ZA/TO:	Kuvendit të Republikës së Kosovës - Z. GLAVK KONJUFCA Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	
CC:		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtëpërdrejtë	
NGA/OD/FROM:	Sindikata e Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Peticion	



Të nderuar anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Duke pasur parasysh kushtet dhe ambientin e punës, Policia e Kosovës është ndër institucionet me rrezikshmërinë më të lartë në shoqëri si nga aspekti i shëndetit ashtu edhe nga aspekti i rrezikut për jetë. Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore përballet me rreziqe të drejtëpërdrejta për jetën dhe shëndetin si dhe situata stresuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë policore. Zyrtarët policor kanë autorizim të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të rrezikshme gjithashtu për jetën dhe shëndetin, i ekspozohen rrezikut në mënyrë permanente dhe të befasishme. Situata të tilla paraqiten në baza ditore rastet si: gjatë përgjigjes në thirrjet e qytetarëve për ndihmë dhe ofrim të shërbimeve; kontrolli dhe siguri i kufirit shtetëror; intervenimit dhe reagimit në rastet e krimeve dhe incidenteve të ndryshme; fatkeqësive natyrore; aksidenteve në trafik; ballafaqimi me trazira dhe prishje të rendit dhe sigurisë publike në përmasa të mëdha; arrestimin dhe transportin e personave me rrezikshmëri; zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit; luftimi i krimit përfshirë por pa u kufizuar vetëm në krimin e organizuar, terrorizmin, narkotikë, kontrabandës me armë dhe mallra, trafikimin me qenie njerëzore; kërkimi dhe arrestimi i personave të arratisur; gjurmimi dhe zbulimi i materieve helmuese dhe eksplozive por edhe trajtimi i materieve të tilla; shpëtimi i pengjeve; rastet e kidnapimit; goditja e grupeve kriminale të organizuara; kërcënimeve me armë dhe materie tjera eksplozive; bazuar në dispozitat ligjore zyrtari policorë, në të gjitha rrethanat, kur e takon një incident në progres ka obligim ligjor 24/7 orë të ndërhyjë dhe t'a menaxhojë incidentin pavarësisht nivelit të rrezikut për jetën e tij, etj.

Për të ilustruar më detajisht specifikat e dhe rrezikshmërinë në punë, flasin të dhënat tona se deri me tani në kryerje të detyrës kanë humbur jetën 23 zyrtarë policor, kanë vdekur në detyrë 322 zyrtarë, 4753 rate të lëndimeve të zyrtarëve policor në kryerjen e detyrave zyrtare, 319 zyrtarë të sëmurë në detyrë, aktualisht me sëmundje të veçanta shëndetësore janë 528 zyrtarë. Deri tani kemi 2285 pjesëtarë të policisë të cilët kanë dhënë dorëheqje vullnetare nga Policia.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lartë dhe pakënaqësive të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, Sindikata e Policisë së Kosovës duke u bazuar në Ligjin mbi Organizimin Sindikal Nr.04/L-11, Ligjit të Policisë së Kosovës Nr.04/L-076 dhe Statutit të Sindikatës ka organizuar këtë Peticion për të treguar se sa janë të pakënaqur Policia e Kosovës me Ligjin e ri të Pagave si: shtesat për rrezikshmëri në punë, shtesat për punë të veçantë, klasifikimin e koeficienteve, zbritja e përvojës së punës nga 0.5 në 0.25 për pesëmbëdhjetë vitet e para, tre pagat përcjellëse për të pensionuarit si dhe shujta ditore, shpërblimi për fund vit në vlerë të një page, sigurimi shëndetësorë dhe jetësor, Ligji për pensionim etj.

Peticioni ka rezultuar me nënshkrimin e 5623 nga gjithsej 9008 të punësuarve, që do të thotë se shumica e të punësuarve, si nga zyrtarët policor ashtu edhe nga stafi civil, në Policinë e Kosovës janë të pakënaqur me kushtet e cekura në Peticion .

Duke u bazuar në pakënaqësitë e të punësuarve në Policinë e Kosovës, të shprehur edhe përmes nënshkrimit të peticionit, Sindikata e Policisë së Kosovës kërkon nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, që të ngritin këtë çështje me qëllim të përkrahjes dhe përmirësimit të kushteve dhe mirëqenies të të punësuarve në Policinë e Kosovës.

Po ashtu kërkojmë nga të gjitha organet Shtetërore të Republikës së Kosovës si nga Presidentja, Kryeparlamentari, Kryeministri dhe Ministri i MPB-së që të aprovohen kërkesat tona të cilat janë jetike për përmirësimin e mirëqenies së të punësuarve në Policinë e Kosovës dhe familjeve të tyre.

Sindikata e Policisë së Kosovës është e gatshme të bashkëpunoj dhe bisedoj për të gjitha këto, me qëllimin më të mirë që këto kërkesa të realizohen në kohë optimale me mirëkuptim dhe në rrugë institucionale.

Peticioni dorëzohet në lista origjinale dhe kërkojmë që të ruhen dhe mbrohen të dhënat personale të të nënshkruarve.

Me respekt:

Imer Zeqiri

Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës

